

## **PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1/Z DHE A2**

### **A1/Z**

#### **PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1/Z DUHET TË KENI PARASYSH QË:**

1. Plotësohet online
2. Kryhet në portalin e-albania

#### **KUSH E PLOTËSON?**

1. Kandidati/kandidatja që ka përfunduar shkollën e mesme para vitit 2020 dhe që ka detyrim për të dhënë një ose disa provime të Maturës Shtetërore;
2. Kandidati/kandidatja që ka kryer arsimin e mesëm jashtë vendit, i cili/e cila pasi ka bere njehsimin e diplomës në komisionin përkatës, në QSHA, rezulton se ka detyrim për të dhënë një ose disa provime të Maturës Shtetërore;
3. Kandidati/kandidatja që ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri ose jashtë vendit, që nuk kanë detyrim për të dhënë provime në MSH 2020, por që dëshiron të vazhdojë studimet në Universitetin “Fan S. Noli”

#### **RRUGA QË NDIQET PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1/Z?**

1. **Aplikohet nw portalin [www.e-albania.al](http://www.e-albania.al).**
  - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania;
  - Zgjidhni shërbimin "Matura Shtetërore";
  - Klikoni butonin "Përdor";
  - Zgjidhni llojin e formularit të aplikimit (A1Z) dhe plotësoni të gjithë të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular;
  - Klikoni butonin “Dërgo” në fund të formularit;
2. **Pasi përfundon me sukses aplikimin në portalin [www.e-albania.al](http://www.e-albania.al), maturanti/kandidati paraqitet pranë shkollës për të përfunduar dhe konfirmuar aplikimin.**

3. Në mjediset e shkollës së mesme kandidati kontakton mbikqyrësin e procesit të aplikimit i cili vendos kodin e aplikantit në sistem dhe konfirmon aplikimin e formularit A1/Z.
4. Formulari i plotësuar printohet, nënshkruhet nga kandidati dhe mbikqyrësi dhe vulloset nga drejtori i shkollës.

**PLOTËSIMI I FORMULARIT NGA MATURANTËT E VITEVE TË MËPARSHME:**

1. Plotësohet në shkollën e mesme ku kandidati ka kryer studimet.
2. Dokumentat që nevojiten janë:
  - a) Kërkesë me shkrim për dhënien e provimeve të maturës shtetërore ose për të aplikuar në IAL.
  - b) Kopje të noterizuar të diplomës bashkë me listën e notave të shkollës së mesme me fotografi lëshuar nga drejtori i shkollës.
3. Për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, bëhet në shkollën e mesme të përcaktuar nga Komisioni i Maturës Shtetërore në Zyrën Vendore Arsimore.